




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjiilan, me datë: 18.01.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. 16.01.2023 në ora 15:33 të parashtruar nga: *OE “ EL BAU SH.P.K. “, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish “, me nr.identifikues 651-22-11628-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 22 102 521 nxjerr:*

V E N D I M

1. **Refuzohet** – kërkesat për ri-shqyrtim të Operatorit Ekonomikë “ EL BAU SH.P.K. “, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish “, me nr.identifikues 651-22-11628-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 22 102 521 të datës 16.01.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-Autoritetit Kontratkues të datës 11.01.2023 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. AK - Komuna e Gjiilanit vendosë të vazhdojë sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK-Autoritetit Kontratkues të datës 11.01.2023.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomikë “ EL BAU SH.P.K. “, me datë 16.01.2023, ka parashtruar kërkesën e tyre për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadish “ me nr.identifikues 651-22-11628-5-2-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 22 102 521. Autoriteti Kontratkues me datë 18.01.2023 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga " EL BAU SH.P.K. ", Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara pasi që bazuar edhe në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues është specifikuar se :

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

I. 1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Aryetim:

AK — Kuvendi Komunal Gjilan bënë anulimin e kësaj procedure të prokurimit, pasi që pas hapjes së ofertave ka konstatuar se një gabim ka ndodhur gjatë zhvillimit të procedurës, më saktësisht te Lista e përshkrimit të çmimeve — paramasës dhe parallogarisë - gabim ky i pariparueshëm në këtë fazë andaj AK merr vendim që ta anuloj këtë aktivitet.

AK do të ndërmerret të gjitha masat për evitimin e këtyre gabimeve dhe së shpejti do të inicoj aktivitet të ri për këtë natyrë.

Gjithashtu, bazuar edhe :

Bazuar në Rregulloren Nr. 001/2022 Neni 44 Formularët Standart pika 44.3. Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues nëformat standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „ header" apo kudo tjetër në dokumentet standarde.


Duke parë pretendimet tuaja Ankimore ne si AK kemi shqyrtuar në detaj këto të fundit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Shqipe Hoxha



Menaxhere e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës.